

## MENAXHMENT - VITI I PARË- SEMESTRI I

### **Mikroekonomi I (O): 7 ECTS**

Qëllimi i kësaj lënde, është që studentët të fitojnë njohuri mbi lëndën Mikroekonomia I dhe disa asete që i përfshinë kjo disiplinë. Disa nga ato asete janë: tregu, çmimet, buxheti etj. Studenti do të jetë në gjendje të dijë edhe kërkesat e tregut, strukturat e tij si dhe njohuri mbi konkurrencën. Në fund të kursit, synohet aftësimi i studentëve për mendim të pavarur lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me Mikroekonominë.

### **Kontabiliteti (O): 6 ECTS**

Qëllimi i kësaj lënde është, që studentët të kompletojnë lëndën dhe të fitojnë njohuri mbi lëndën e kontabilitetit, të kuptojnë rolin e kontabilitetit në marrjen e vendimeve lidhur me organizatën, veprimtarinë në kuadër të bizneseve, konceptet themelore të matjeve në kontabilitet, raportimin e fitimeve dhe situatave financiare, qëllimin dhe përmbajtjet e raportit të rrjedhjes monetare, konceptet dhe analizën e aktiviteteve financiare. Pas përfundimit të këtij moduli, studentët do të jenë në gjendje, të njohin zhvillimin historik të kontabilitetit dhe procesit të evidentimit të transaksioneve ekonomike.

### **Gjuhë Angleze I (O): 6 ECTS**

Qëllimi i kësaj lënde është, që studentët të cilët përfundojnë me sukses këtë kurs, do të jenë në gjendje të kuptojnë, komunikojnë anglisht, me gojë dhe me shkrim, të shqyrtojnë tendencat dhe modelet e përdorimit të metodave të ndryshme në të mësuarit, të analizojnë dhe vlerësojnë tekstin e punës si dhe të aplikojnë koncepte dhe teknika adekuate të të mësuarit e anglishtes.

### **Matematikë (O): 6 ECTS**

Qëllimi i kësaj lënde është, që pas përfundimit, studentin do të jetë në gjendje që të njohë mirë bashkësinë e numrave natyralë, të plotë, racionalë dhe irracionalë, që e përbëjnë bashkësinë e numrave realë, të njohë dhe të dijë e zbatojë formulat e

binomit, të zgjidhin barazime me një të panjohur, të dijë të zgjidh sistemet e ekuacioneve me dy dhe tri të panjohura, matricat dhe determinantet, etj.

### **Sociologjia (Z): 5 ECTS**

Qëllimi i kësaj lënde është, që të zhvillojë aftësitë e studentëve për të gjykuar, kuptuar dhe shpjeguar ndërlidhjet e fenomeneve të përgjithshme shoqërore. Studentët nga ky kurs, do të përfitojnë njohuri për kauzalitetin e dukurive, marrëdhënieve dhe proceseve shoqërore në jetën e përditshme. Studentët, pas përfundimit të këtij kursi, do të jenë në gjendje që në mënyrë kritike të gjykojnë, vlerësojnë dhe shpjegojnë proceset e përgjithshme shoqërore, ndikimin e fenomeneve sociale dhe të mjedisit social në funksionimin praktik të institucioneve shtetërore dhe politike, si dhe për proceset e globalizimit në shoqërinë bashkëkohore.

### **Hyrje në Administrimi Publik [Z]: 5 ECTS**

Qëllimi i kësaj lënde është që studentët të fitojnë njohuri mbi administrimin publik, të jenë të aftë në parimet dhe proceset administrative, menaxhimin e organizatave publike dhe jo-publike, politikat publike, teoritë në administrimin publik, dhe mbi ekonomin e sektorit publik. Të jenë në gjendje në përgatitjen e dokumenteve administrative, në planifikimin dhe koordinimin e punëve ndër-institucionale, në arkivimin dhe regjistrimin e lëndëve administrative përmes sistemit të informacionit.

### **Pskikologji [Z]: 5 ECTS**

Qëllimi është që studentët përmes kësaj lënde të njohohen me dinamikat psiqike të kondicionit si dhe të sjelljes, ti mësojnë faktorët që ndikojnë në to, qofshin faktor social, psikologjik, personal apo fiziologjikë. Të aftësohen në mënyrat e çrregullimeve, të aftësohen në parandalimin e tyre dhe trajtimin e tyre me anë të teknikave psikologjike të kurimit, duke aplikuar çdo njohuri në pjesën praktike.

## MENAXHMENT - VITI I PARË- SEMESTRI II

### **Makroekonomi I (O): 7 ECTS**

Qëllimi i kësaj lënde është, që studentët që do të jenë pjesë e këtij kursi dhe ligjëratave që do të mbahen, do të jenë në gjendje: të marrin informacione mbi shkencën ekonomike në përgjithësi, të kuptojnë konceptet ekonomike, të absorbojnë njohuri mbi objektivat ekonomike, të kuptojnë ekuilibrin dhe disekuilibrin e tregut, etj.

### **E drejta Biznesore (O): 6 ECTS**

Qëllimi i kësaj lënde është, që studentët pas përfundimit të kursit të jenë në gjendje të shfrytëzojnë të dhënat statistikore, interpretimin e tyre, dhe me anë të tyre të bëjnë studimin e dukurive shoqërore, ekonomike, natyrore, etj. Të bëjnë paraqitjen grafike të të dhënave.

### **Gjuhë Angleze II (O): 6 ECTS**

Qëllimi kryesor i lëndës, Gjuhë Angleze II është që t'i njohë studentët me konceptet e katër shkathtësive të gjuhës angleze. Edhe nga vetë përmbajtja e shkurtër e paraqitur më lart, si rezultate të pritura janë: terminologjitë ekonomike, në gjuhën angleze, aspekti i raporteve ekonomike ndërkombëtare, etj.

### **Statistikë (O): 7 ECTS**

Qëllimi i kësaj lënde është, që studentët pas përfundimit të kursit të jenë në gjendje: të shfrytëzojnë të dhënat statistikore, interpretimin e tyre, dhe me anë të tyre të bëjnë studimin e dukurive shoqërore, ekonomike, natyrore etj. Të bëjnë paraqitjen grafike të të dhënave.

### **Ekonomia e Kosovës (Z): 5 ECTS**

Qëllimi i kësaj lënde është, që studentët që do të jenë pjesë e këtij kursi, të mund të fitojnë njohuri mbi: lëndën, detyrat dhe arsyen për hulumtime, kushtet dhe burimet natyrore, rolin e relievit dhe hapësirës, ujërave e mineraleve, etj.

### **Integrimet Ekonomike Evropiane [Z]: 5 ECTS**

Qëllimi i kësaj lënde është që studentë të njoftohen me njohuritë bazike për integrimet ekonomike evropiane, duke e ndërlidh procesin e integrimit european ekonomik me shtetin e Kosovës, të njoftohen me politikat fiskale të BE-së, politikat monetare të saj, integrimin e tregut në ekonomin evropiane, bashkësinë ekonomike evropiane, politikat e zhvillimit të tregut të industrisë e bujqësisë, paktin e stabilitetit etj.

### **Hyrje në Ekonomin Ndërkombëtare [Z]: 5 ECTS**

Qëllimi i kësaj lënde është që studentët të jenë në gjendje të i njoh kornizat e ekonomisë ndërkombëtare, ta njoh ambientin dhe format ekonomike, politike e ligjore të ekonomisë ndërkombëtare, të i njoh proceset globale dhe strategjike, ti njoh kushtet e liberalizimit të tregut dhe globalizimit, ti njoh praktikatat e ekonomive ndërkombëtare etj.